



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 555/Prot  
4

Tiranë, më 12/6/2020

VENDIM

Nr. 14, datë 12 . 6 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankueset, znj. \_\_\_\_\_, znj. \_\_\_\_\_ dhe znj. \_\_\_\_\_ kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 555 Prot., datë 19.05.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkisë Tropojë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankueset, në cilësinë e kërkueseve, nëpërmjet shkresave të datës 30.04.2020, kanë kërkuar t’u vihet në dispozicion dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. *Vendimin e Këshillit Bashkiak me anë të cilit është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit për periudhën Gusht 2019 – Prill 2020.*
2. *Strukturat organike të miratuara me urdhër të titullarit për periudhën Gusht 2019 – Prill 2020.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoritetit Publik, me pretendimin se janë cënuar në të drejtën për informim, ankueset kanë paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankueset legjitimohen në kërkimin e tyre.



Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 555/2 Prot, datë 20.05.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Me shkresën nr. 2068/1 Prot., datë 27.05.2020, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se, ka vënë në dispozicion të kërkueseve dokumentacionin lidhur me: *“VKB nr. 60, datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2020, si viti i parë i PBA-së 2020-2022”, si dhe Urdhëri nr.83, datë 15.04.2020 “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë miratuar me datë 30.12.2019”*.

Duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, ankueset nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail) të datës 03.06.2020 kanë vijuar ankimin duke kërkuar dhe sqaruar se kërkojnë vënien në dispozicion të *“Strukturës së miratuar në Dhjetor 2019 sikurse është shprehur në Urdhërin nr. 83, datë 15.04.2020 “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë miratuar me datë 30.12.2019”*.

Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 10.06.2020, Autoriteti Publik ka informuar Zyrën e Komisionerit se me shkresat nr. 1703/8 Prot., nr. 1701/8 Prot., nr. 1681/8 Prot., datë 09.06.2020 i ka kthyer përgjigje kërkueseve duke vënë në dispozicion Urdhër Nr. 105/2, datë 24.01.2020, *“Strukturën Organike të Bashkisë Tropojë”*.

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, përgjigja e Autoriteti Publik nuk është e plotë në lidhje me pikën 2 të kërkesave për informacion datë 30.04.2020.

Dokumentacioni i kërkuar në pikën 2 të ankesës së paraqitur përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* dhe rrjedhimisht i duhet venë në dispozicion kërkuarit.

Gjithashtu, theksojmë se informacioni i kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni i cili, bazuar në pikën a) të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* çdo autoritet publik vë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet *“një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik”*, duhet të jetë publikuar në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik, si dhe t'i vihet në dispozicion publikut pa kërkesë.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. \_\_\_\_\_, znj. \_\_\_\_\_ dhe znj. \_\_\_\_\_ ndaj Bashkisë Tropojë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.



Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 555 Prot., datë 19.05.2020 të znj. \_\_\_\_\_, znj. \_\_\_\_\_ dhe znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tropojë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 2 të kërkesave të datës 30.04.2020 (“Strukturën e miratuar në Dhjetor 2019 sikurse është shprehur në Urdhrin nr. 83, datë 15.04.2020 “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë miratuar me datë 30.12.2019”), brenda datës 19.6.2020.
3. Rrëzimin e ankesës për informacionin e kërkuar në pikën 1 (Vendimin e Këshillit Bashkiak me anë të cilit është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit për periudhën Gusht 2019 – Prill 2020), si dhe rrëzimin pjesërisht të ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikën 2 (Urdhër Nr. 105/2, datë 24.01.2020, “Strukturën Organike të Bashkisë Tropojë”), të kërkesave për informacion të datës 30.04.2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 12.6.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

